L I G J
Nr.8563, datë 22.12.1999

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE, SH.A.

(Ndryshuar me ligjin nr.8806, datë 17.5.2001; nr. 8900, datë 23.5.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
(Shtuar fjalë dhe paragraf me ligjin nr.8806, datë 17.5.2001)

Forma e privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a. do të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë 100 për qind të aksioneve të saj të tretëve, nëpërmjet shitjes ose shitjes me kusht", sipas formulës së privatizimit të parashikuar në këtë ligj.

Në rast se marrëveshja për transferimin e të drejtës së pronësisë të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a. do të bëhet me kushte, kjo marrëveshje duhet të miratohet nga Kuvendi.

Neni 2

Formula e prvatizimit për Bankën e Kursimeve është si më poshtë:

1. Jo më pak se 35 për qind e aksioneve do t'i transferohen nëpërmjet shitjes një investitori strategjik, me të cilin nënkuptohet një ose disa banka, që do të zgjidhen nëpërmjet metodës së tenderit të hapur ndërkombëtar.

2. Jo më shumë se 49 për qind e aksioneve do t'u ofrohen nëpërmjet shitjes institucioneve financiare ndërkombëtare.

3. Jo më shumë se 24 për qind e aksioneve do t'u ofrohen nëpërmjet shitjes me ofertë publike personave fizikë dhe juridikë shqiptarë.

Neni 3

Transferimi i së drejtës të pronësisë së aksioneve do të bëhet vetëm me valutë.

Neni 4

Në rast se në përfundim të procedurave, sipas nenit 2 të këtij ligji, do të mbeten aksione të patransferuara, pronari i tyre do të jetë shteti, i cili përfaqësohet me këtë cilësi nga Ministri i Financave.

Ministria e Financave ka të drejtë të negociojë me investitorët e zgjedhur, sipas

nenit 2 të këtij ligji, për transferimin e pjesës së mbetur të aksioneve në pronësi të shtetit ose të vazhdojë procedurat ligjore për transferimin e tyre personave të tretë jashtë shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit tregtar dhe bankar.

Në kuptim të këtij neni, procedurat e përcaktuara në nenet 206 dhe 207 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" nuk zbatohen.

Neni 5

Investitorët, të cilët do të marrin pjesë në procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a., janë të detyruar të përmbushin të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe bankar i Republikës së Shqipërisë, nga aktet e tjera ligjore në fuqi dhe nga ato që do të miratohen më vonë për këtë çështje.

Neni 6

Ngarkohet Ministria e Financave që në zbatim të këtij ligji të hartojë dhe të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave aktet nënligjore përkatëse, si dhe të organizojë procedurat për privatizimin nëpërmjet shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve, sh.a.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme në zbatim të këtij ligji dhe të përgatisë strategjinë e ristrukturimit të Bankës së Kursimeve sh.a. përpara fillimit të procedurave të privatizimit.

Neni 7/1
(Shtuar me ligjin nr. 8900, datë 23.5.2002)

1. Banka e Kursimeve sha deri më 31.12.2010 nuk do t'u nënshtrohet detyrimeve të neneve 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.8044, datë 7.12.1995 "Për konkurrencën". Gjatë kësaj periudhe Banka e Kursimeve do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi, që trajtojnë abuzimin me pozitën dominuese në treg.

2. Ngarkohen Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Ekonomisë të përcaktojnë norma specifike të mbikëqyrjes për moslejimin e rasteve të abuzimit me pozitën dominuese në treg".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2527, datë 17.1.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.